



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2020:067175

Datë: 31.05.2022

Numri i dokumentit: 03076120

E.nr.877/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorës B.G nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 30.05.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën E.nr.877/21, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorës.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.877/21, të datës 19.07.2021, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorës, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.899/20, të datës 24.11.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 22.10.2021, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,260.62 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
E.nr.877/21, më datë 30.05.2022

**GJYQTARI**  
Faton Ajvazi